



NEWSLETTER

15 • KORRIK 2021




Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.

MBLEDHJE BORDI NR.34
30.06.2021

VENDIME

Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar.



NEWSLETTER

15 • KORRIK 2021



MBLEDHJE BORDI NR.34
30.06.2021

Mbi modifikimin e një license për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”.

VENDIME

Mbi rishikimin e programit të transparencës dhe regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve të ERE-s.



NEWSLETTER

15 • KORRIK 2021




MBLEDHJE BORDI NR.34
30.06.2021

VENDIME

Mbi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për zgjatjen e periudhës kohore, të parashikuar në pikën 3, të vendimit nr. 89, datë 31.03.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 Prill 2021”

Mbi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020, për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”.



NEWSLETTER

15 • KORRIK 2021




MBLEDHJE BORDI NR. 35
02.07.2021

Mbi kërkesën e një shoqërie për lënien peng të aseteve të luajtshme, paluajtshme në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

Mbi shqyrtimin dhe mosmiratimin e kërkesës nga AREA për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 116, datë 30.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqatës AREA për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020”

Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e kodit të transmetimit.

VENDIME



NEWSLETTER

15 • KORRIK 2021



MBLEDHJE BORDI NR.36
12.07.2021

Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Qershor 2021.

Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të një shoqërie të licensuar.

Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licensuarit”.

VENDIME

Kjo rregullore, e cila përbëhet nga 3 pjesë dhe 13 nene, ka për qëllim të përcaktojë procedurën, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për të licencuarit në një nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike ose të gazit natyror, që paraqesin kërkesën për:

(i) ndryshimin e statusit ligjor;

(ii) ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e shoqërisë së licencuar, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;

(iii) hipotekimin, barrësimin, lënien peng, barrë, ose çfarë do lloj disponimi tjetër të të tretët të kuotave apo aksioneve, kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortakut/aksioneri që kontrollojnë interesat e shoqërisë së licencuar.

Mbi shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit.



Takimi i 4-t i Officerëve ndërlidhës së Rregullatorëve anëtarë të ERRA

Në datën 07 korrik 2021 u zhvillua nga ERRA (Shoqata Rajonale e Rregullatorëve të Energjisë) aktiviteti i përbashkët me pjesmarrje të oficerëve komunikues të të gjithë anëtarëve të shoqatës. Pjesmarrëset nga Enti Rregullator i Energjisë, prezantuan strategjitë e përdorura nga ERE për shpërndarjen e informacionit dhe përditësimin e grupeve të interesit, përgjatë periudhës së COVID-19.

ERRA 4th Liaison Officers' meeting

Members' updates
ERE ALBANIA

EDITA HOXHA
International Affairs Policy Officer

Recent activities

- Annual Report 2020 – Approved 1st of July
- Customer Protection: Protection from discrimination of vulnerable customers, through the implementation of the legal and regulatory framework.
- Customer survey- Launched
- Complaints Register
- Digital price comparison tools
- Memorandum of cooperation ERE - Faculty of Law (UT)
- Online Webinars
- ERE ALBANIA NEWSLETTER
- New Website Design
- New Study on the consumption of electricity by household at industry consumers for 2019-2020

ERRA Online Meeting of the Liaison Officers
July 7, 2021

121

RAPORTI VJETOR

U prezantua në datën 1 korrik 2021, Raporti Vjetor i ERE në Kuvendin e Shqipërisë, nga Kryetari, Z. Petrit Ahmeti. Në këtë raport janë paraqitur në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për Vitin 2020, si dhe krahasimet e disa prej treguesve të këtij viti me vitet parardhës.



Gjatë fjalës së tij, Z. Ahmeti në mënyrë të përmbledhur prezantoi gjëndjen e këtij sektori dhe veprimtarinë e ERE-s përgjatë Vitit 2020. Ndër të tjera ai vuri theksin mbi aktivitetin vjetor të ERE-s me qëllim garantimin e përbushjes së detyrimeve të pjestarëve të tregut për të siguruar furnizimin me energji, me cilësi dhe me kosto sa më të ulët të klientëve si dhe rikujtoi që në bashkëpunim të ngushtë me partnerët kryesorë të përpilimit të legjislacionit primar dhe sekondar, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë, MIE, Autoritetin e Konkurrencës etj., ERE do të

ketë në fokus implementimin e paketës së katërt legjislative, atë të paketës së pastër, krijimin e bursës së Energjisë Elektrike, në drejtim të zbutjes së efekteve tek klientët fundorë, vijimin dhe konsolidimin e procesit të ndarjes së OSSH në përputhje me detyrimet ligjore dhe angazhimet ndërkombëtare, si dhe zhvillimin më tej të kuadrit rregullator për sektorin e gazit natyror. Me gjithë arritjet e prezantuara në raport, duke konsideruar se ende mbetet shumë për të punuar në kuadër, Z. Ahmeti në mbyllje të fjalës së tij tha se puna e ERE në vijim do të fokusohet në çështje që lidhen me miratimin dhe zbatimin e rregullores së transparencës dhe integritetit të tregut me shumicë të energjisë elektrike, monitorimi i implementimit të ndarjes funksionale dhe organizative të OSHEE-së, zbatimi i planit strategjik, reforma në sektorin elektro - energjitik, impakti i burimeve të rinovueshme dhe zbatimi i strategjisë për infrastrukturën kritike.

Gjithashtu Z. Ahmeti ju përgjigj dhe pyetjeve të disa prej anëtarëve të kuvendit. Në fund të seancës nga ana e Kuvendit u mbështet veprimtaria e ERE-s për vitin 2020 si dhe u votua Projekt Rezoluta "PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGISË PËR VITIN 2020" paraqitur nga ana e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, me detyrat për ERE përgjatë vitit 2021.

Kodi i Trasmetit është një akt nënligjor rregullativ i cili shërben për garantimin e funksionimit normal të Sistemit Elektroenergjitik të vendit. Ai përcakton qartë kufinj të pronësisë së asetëve dhe kufijtë e menaxhimit operacional midis kompanisë OST sh.a dhe përdoruesve të rrjetit të transmetimit apo pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, përcakton normat (rregullat, standartet teknike etj.) për operimin dhe zhvillimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit, në përputhje me zhvillimin e Tregut Shqiptar dhe Rajonal të Energjisë Elektrike. Kodi përcakton procedurat e marrëdhënieve ndërmjet shoqërisë "OST" sh.a dhe përdoruesve të rrjetit të transmetimit/pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij dokumenti OST sh.a. ERE nëpërmjet vendimit nr. 160 datë 02/07/2021 ka filluar procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e Kodit të Transmetimit të përcjellë nga OST sh.a.

Kodi përbëhet nga disa kapituj:

i) Kapitulli i Dispozitave të Përgjithshme i cili siguron sa është e mundur, që kodet e veçanta pjesë përbërëse të Kodit të Transmetimit, të funksionojnë së bashku dhe të jenë të zbatueshëm në praktikë.

ii) Kapitulli mbi Planifikimin e Sistemit të Transmetimit i cili specifikon dhe përcakton normat standartet, kushtet, kriteret, afatet kohore për planifikimin e zhvillimit të sistemit të transmetimit nga OST sh.a.

iii) Kapitulli i Lidhjes me Sistemin e Transmetimit i cili specifikon kushtet dhe parametrat teknike, procedurat, rregullat dhe afatet kohore në baza jodiskriminuese për aplikimin për një lidhje të re me sistemin e transmetimit ose për të modifikimin e lidhjeve ekzistuese në këtë rrjet.

iv) Kapitulli i operimit i cili ka si qëllim ruajtjen e sigurisë së operimit, cilësinë e frekuencës dhe shfrytëzimin efikas të sistemit të interkonektuar dhe burimeve, ky kod përcakton udhëzime të hollësishme mbi operimin e sistemit të transmetimit në veçanti dhe atë elektroenergjitik në tërësi.

v) Kapitulli i Emergjencave dhe Restaurimit i cili shërben për ruajtjen e sigurisë operacionale dhe parandalimin e përhapjes së një incidenti në shkallë të gjerë dhe rënien e plotë të sistemit, si dhe për të lejuar rikthimin e shpejtë dhe efikas në gjendjen normale të sistemit nga gjendja e alarmit ose black-out-it.

vi) Kapitulli i operimit të tregut dhe rregullat e matjes i cili përmban rregulla të përgjithshme mbi çështjet që lidhen me funksionimin e Operatorit të Tregut, operimin e tregut, si dhe marrëdhëniet midis OT dhe OST, OSSH dhe përdoruesve të rrjetit të transmetimit.

KODI I TRANSMETIMIT

Kodi i Ri i Transmetimit ka rishikuar procedurat përkatëse për aplikimin për lidhjen me sistemin me qëllim qartësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe të etapave dhe afateve nga aplikimi për lidhje deri në energjizimin dhe fillimin e operimit të përdoruesve. Gjithashtu, janë reflektuar dhe përfshirë si dispozita të reja, detyrimet sipas VKM-ve nr.482 dhe 483, dt.17/06/2020 në lidhje me: pajisjet dhe materialet; specifikimet për kompanitë private të instalimeve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike ; dokumentimi dhe operimi instalimeve elektrike të tensionit të lartë, në pronësi të kompanive të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike; mirëmbajtja, kontrollet periodike dhe inspektimet e instalimeve të tensionit të lartë, në pronësi të kompanive të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike; operimi dhe mirëmbajtja e instalimeve private të tensionit të lartë, të cilat janë pjesë e impianteve të transmetimit ose të shpërndarjes së energjisë elektrike; dokumentacioni, vënia në shfrytëzim dhe mirëmbajtja e linjave dhe inspektimet periodike të linjave.

Kodi i Ri i Transmetimit gjithashtu ka rishikuar kapitulli në lidhje me Operimin e Sistemit bazuar në Rregulloren e Komisionit të BE 2017/1485, 2 Gusht 2017, për përcaktimin e "Udhëzuesit për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike". Kjo pjesë e kodit vendos rregulla të harmonizuara për OST sh.a. dhe përdoruesit për të garantuar sigurinë e sistemit, disponueshmërinë, shëmbimin e të dhënave, integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, përdorimin efikas të rrjetit, rritjen e konkurrencës dhe të përfitimit të konsumatorëve.

Në ndryshim nga kodi aktual, i cili është miratuar me vendimin e Bordit të ERE 186/2017, ndryshuar me 129/2018, drafti i ri i Kodit të Transmetimit i propozuar nga OST sh.a., ka rregulla të veçanta të cilat adresojnë çështjet që lidhen me Kushtet e Emergjencave dhe Rivendosjes së Sistemit, të cilat bazohen në Rregulloren e Komisionit të BE 2017/2196, 24 Nëntor 2017, për përcaktimin e "Kodit të Rrjetit të Emergjencave të Energjisë Elektrike dhe Rivendosjes". Dispozitat e kësaj pjesë të kodit përcaktojnë procedurat dhe veprimet që duhet të kryhen specifikisht në gjendjen e emergjencës, black-out dhe rivendosjes të cilat janë hartuar si një grup i përbashkët i parimeve dhe kërkesave teknike minimale duke pasur në konsideratë marrjen e masave parandaluese apo përmiresuese në kushtet e operimit sinkron me rrjetin evropian.

Në draftin e ri të Kodit të Transmetimit janë rishikuar edhe rregullat që lidhen me Operimin e Tregut dhe Rregullat e Matjes me një fokus të veçantë në këto të fundit. Kjo pjesë e kodit adreson funksionimin e Operatorit të Tregut, operimin e tregut, si dhe marrëdhëniet midis OT dhe OST sh.a., OSSH sh.a., dhe përdoruesve të sistemit të transmetimit.

Në të njëjtën kohë rregullat e matjes të përfshira në draftin e kodit (përfshirë matësin, sistemin e matjes dhe veprimtarinë e matjes) përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për OST sh.a., përdoruesit e sistemit të transmetimit si dhe të pjesëmarrësve të tregut. Këto rregulla vijnë si domosdoshmëri edhe për faktin se kodi i matjes i miratuar me vendimin e Bordit Nr.101, datë 26/08/2008, ka një kohë të gjatë i pa rishikuar.

Rregjistri i Kërkesave dhe Ankesave

Në databazën e publikuar në web sa i perket ankesave të konsumatorëve të energjisë elektrike, databazë është azhornuar së fundmi me ankesat dhe të dhënat e konsumatorëve deri në javën e dytë të muajit Qershor 2021. Ankesat e adresuara në ERE mund të gjurmohen në lidhje me trajtimin e tyre nga ana e ERE apo marrjen e përgjigjes nga ana e të liçencuarit ndaj të cilit është ushtruar ankim. Rregjistri i Kërkesave/Ankesave në linkun-n më poshtë.

<https://ere.gov.al/sq/transparenca/rregjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve>



@enti_rregullator_energjisë



Enti Rregullator i Energjisë



@EreEnti




ERE Albania

ANKETA E KONSUMATORIT

Në funksion të përmirësimit të shërbimit të ofruar nga institucioni, Enti Rregullator i Energjisë, ju fton të plotësoni anketën e mëposhtme në linkun:

https://docs.google.com/forms/d/1AQwkqz8R7UpDyRWBduLmlHaXmOgqW17pzlLWBZrswQg/viewform?edit_requested=true



NEWSLETTER

15 • KORRIK 2021



INFORMACION

Vendimet e Bordit ERE:

<https://ere.gov.al/sq/publikime/vendimet>

Raporti Vjetor:

<https://ere.gov.al/sq/publikime/raporte-vjetore>

Njoftime:

<https://ere.gov.al/sq/publikime/njoftime>

Rregullat për Proçedurat e Liçensimit:

<https://ere.gov.al/sq/licensat/rregullore-per-licensimin>

Metodologjitë e Tarifave:

<https://ere.gov.al/sq/tarifat/metodologjia-e-tarifave>

Tarifat për lidhje në tension të ulët 21-50 kW

Tarifat për Konsumatorët familjare

T1 = 1000 Lekë

T2 = sipas tabelës së distancave (vlerë e fiksuar e tarifës brenda 200m është 2000lek; vlerë e shtuar për çdo 100m është 1000lek.)

T3 = 2,000 Lek/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes.

- 
- Tarifat për Konsumatorët jo familjare janë si vijon:
 - T1 = 5000 Lekë
 - T2 = sipas tabelës së distancave (vlerë e fiksuar e tarifës brenda 200m është 2000lek; vlerë e shtuar për çdo 100m është 1000lek.)
 - T3 = 2.500 Lek/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)
 - T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes.



·Tarifat për shtesë fuqie, modifikim lidhje ose transferim për Konsumatorët familjarë në tension të ulët:

·T1 = 0 lekë

·T2 = sipas tabelës së distancave

·T3 = 2000 Lek/kW (kundrejt fuqisë shtesë të kërkuar)

·T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes.



·Tarifat për shtesë fuqie, modifikim lidhje ose transferim për Konsumatorët Jo familjarë në tension të ulët:

·T1 = 0 lekë

·T2 = sipas tabelës së distancave

·T3 = 2500 Lek/kW (kundrejt fuqisë shtesë të kërkuar)

·T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes.